

FJALË PËRSHËNDETËSE

Të nderuar organizatorë,

Të nderuar pjesëmarrës, zonja dhe zotërinj,

Është kënaqësi dhe nder i veçantë për mua të jem sot pjesë e kësaj konference të rëndësishme me temën “Trashëgimia është e drejta jote – Mbroje!”, e cila trajton një nga çështjet më thelbësore të shoqërisë sonë: të drejtën në pronë dhe në trashëgimi.

Kjo nismë vjen në një kohë të duhur, kur fuqizimi i të drejtave ligjore, rritja e ndërgjegjësimit publik dhe garantimi i qasjes së barabartë në informacion janë domosdoshmëri për një shoqëri demokratike dhe të drejtë. Veçanërisht, kjo temë prek drejtpërdrejt gratë, të rinjtë dhe komunitetet në zonat rurale, ku praktikrat tradicionale shpesh ende ndikojnë në kufizimin e të drejtave të tyre.

Në këtë kuadër, bashkëpunimi rajonal ndërmjet Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut përbën një vlerë të shtuar. Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira është thelbësor për ndërtimin e një sistemi më të drejtë, më efikas dhe më të ndjeshëm ndaj të drejtave të qytetarëve në fushën e pronës dhe trashëgimisë.

Të nderuar të pranishëm,

Jam veçanërisht e nderuar që sot ju drejtohem në cilësinë e Kryetares së parë grua në krye të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Këtë përgjegjësi nuk e shoh si një privilegj personal, por si një arritje të përbashkët shoqërore dhe institucionale.

Para meje dhe bashkë me mua, kanë qenë dhe janë shumë gra me kontribute të jashtëzakonshme në shkencë, arsim dhe kulturë, të cilat shpesh janë përballur me barriera të heshtura të natyrës patriarkale. Prandaj, këtë moment e lexoj si dëshmi se “tavani i qelqtë”, si një metaforë e kufizimeve të padukshme ndaj grave në pozita udhëheqëse, po fillon të sfidohet dhe të thyhet.

Sot, në Kosovë, jemi dëshmitarë të një realiteti të ri: vajzat dhe gratë përbëjnë shumicën në universitete, diplomohen me rezultate të larta dhe tregojnë përkushtim të jashtëzakonshëm në dije. Ky është një transformim i rëndësishëm shoqëror, që dëshmon se qasja në arsim nuk është më pengesë për gratë. Por, përballë këtij suksesi qëndron një paradoks i thellë. Si shpjegohet që ky kapital i madh njerëzor nuk përkthehet mjaftueshëm në pjesëmarrje të barabartë në tregun e punës dhe në vendimmarrje? Në këtë pikë, shfaqet qartë dallimi mes suksesit arsimor dhe barazisë reale ekonomike e sociale.

Dija, siç na mëson edhe ekonomisti Gary Becker, është kapital njerëzor. Por ky kapital humb fuqinë e tij kur nuk shoqërohet me mundësi reale për punësim, pronë dhe pavarësi ekonomike. Në shumë raste, gratë tona, edhe pse të arsimuara, përballen me papunësi ose varësi ekonomike, duke e kufizuar potencialin e tyre. Për këtë arsye, duhet të kalojmë nga barazia formale në barazi reale dhe strukturore. Suksesi individual nuk mjafton nëse strukturat shoqërore dhe institucionale vazhdojnë të riprodhojnë pabarazi. Siç thekson John Rawls, drejtësia nuk matet me raste të veçanta suksesi, por me drejtësinë e vetë strukturës së shoqërisë. Po ashtu, Iris Marion Young na kujton se padrejtësia shpesh nuk është rezultat i veprimeve individuale, por i strukturave që prodhojnë përjashtim në mënyrë të vazhdueshme. Në këtë kontekst, një nga

dimensionet më kritike mbetet agjencia ekonomike e grave. Sipas Naila Kabeer, agjencia nuk është vetëm arsim apo aftësi, por aftësia reale për të marrë vendime dhe për t'i zbatuar ato në jetën praktike.

Pa pronë, pa të ardhura dhe pa kontroll mbi burimet ekonomike, liria mbetet jo e plotë. Prandaj, trashëgimia nuk është thjesht çështje juridike apo teknike — ajo është çështje e drejtpërdrejtë e dinjitetit dhe autonomisë njerëzore. Në këtë drejtim, roli i noterëve dhe gjyqtarëve është thelbësor. Ata nuk janë vetëm zbatues të procedurave ligjore, por garantues të vullnetit të lirë të qytetarit, veçanërisht të grave që shpesh përballen me presione familjare apo shoqërore për të hequr dorë nga e drejta e tyre në trashëgimi.

Statistikat që tregojnë se një përqindje e madhe e grave heqin dorë nga trashëgimia, nuk flasin për mungesë ligjesh, por për ndikimin e normave shoqërore dhe kulturës së trashëguar të pabarazisë. Në këtë kuptim, drejtësia gjinore nuk mund të kuptohet pa rishpërndarje ekonomike, siç e thekson Nancy Fraser. Po ashtu, mungesa e pronës krijon atë që është quajtur "varësi strukturore", ku liria formale nuk shoqërohet me liri reale.

Ne duhet të eliminojmë edhe atë që Miranda Fricker e quan "padrejtësi hermeneutike" — ku kontributi i grave nënvlerësohet sepse strukturat tona refuzojnë t'i japin vlerën e duhur punës dhe intelektit të tyre. Si ta kapërcejmë këtë anomali? Kjo nuk arrihet me dëshira të mira, por me politika të drejtpërdrejta shtetërore, si:

1. ***Integrimi i detyrueshëm i meritokracisë:*** Shteti duhet të garantojë përfshirjen e grave me ekspertizë të dalluar në borde drejtuese dhe sektorë strategjikë si energjia dhe teknologjia.
2. ***Adresimi i ekonomisë së papaguar:*** Pa investime në infrastrukturën e kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit, potenciali i grave do të mbetet i mbyllur brenda mureve të shtëpisë.
3. ***Reforma e trashëgimisë si prioritet kombëtar:*** Mbështetja e reformave që bëjnë regjistrimin e pronës së përbashkët të detyrueshëm dhe fuqizimi i rolit mbikëqyrës të noterëve.

Prandaj, reforma në fushën e trashëgimisë, forcimi i zbatimit të ligjit dhe mbrojtja aktive e të drejtave të grave janë domosdoshmëri institucionale.

Të nderuar pjesëmarrës,

Emancipimi i vërtetë nuk është simbolik. Ai matet me kontroll mbi burimet ekonomike, me qasje në pronë dhe me pjesëmarrje të barabartë në vendimmarrje. Na duhen gra në shkencë, në ekonomi, në teknologji, në bujqësi, në art dhe në çdo fushë të zhvillimit shoqëror. Por mbi të gjitha, na duhen gra me pavarësi ekonomike dhe me të drejtë të plotë mbi pronën e tyre. Vetëm atëherë mund të flasim për barazi reale dhe për një shoqëri të drejtë. Në përmbyllje, ju uroj punë të mbarë në këtë konferencë dhe shpresoj që diskutimet dhe rekomandimet e saj të shndërrohen në hapa konkretë institucionalë dhe politikë.

Ju faleminderit për vëmendjen dhe për ftesën.